



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 3610/4 /prot.

Tiranë, më 05.07.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.523, datë.05.10.1999.

SHOQËRISË “MIN- EX” SH.P.K
Pallati 18, Shkalla e Parë, Kati i Dytë, Krastë, Bashkia Bulqizë.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “Min - Ex” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.523 datë 05.10.1999, për mineral kromi, në objektin “Sheshi i Çukës”, Tërnovë, Bashkia Bulqizë.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së në përgjigje të kërkesës tuaj, me shkresën nr.2360/2, datë 10.06.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.3610/2 datë 12.06.2019, është propozuar revokimi i lejes nr.523 datë 05.10.1999, për mineral kromi, në objektin “Sheshi i Çukës”, Tërnovë, Bashkia Bulqizë.

Kërkesa juaj është për mbylljen e aktiviteti minerar në objektin fjalë, për të cilin shoqëria juaj zotëron leje minerare nr.513 datë 05.10.1999 dhe bazohet në nenin 47, pika 2, germa “a” të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar ku thuhet:

“ Leja minerare, që përfshin shfrytëzimin minerar, revokohet edhe:

a) me kërkesë të zotëruesit, kur ai ka plotësuar të gjitha detyrimet e lejes minerare;”

Afati i vlefshmërisë së lejes është 20 vite, që përfundon me datë 05.10.2019 dhe nga ana Juaj nuk është bërë kërkesë për zgjatjen e këtij afati, një vite para se të mbaronte afati i vlefshmërisë së lejes, pra para datës 05.10.2018.

Në shkesën e AKBN-së thuhet se shoqëria nuk ka detyrime për të shlyer, në objekt kanë përfunduar rezervat gjeologjike dhe nga shoqëria kërkohet mbyllja e aktivitetit minerar, prandaj propozohet revokimi i lejes nr.513 datë 05.10.1999, për mineral kromi, në objektin “Sheshi i Çukës”, Tërnovë, Bashkia Bulqizë. Nga ana e shoqërisë tuaj duhet të hartohet projekti i mbylljes së aktivitetit minerar, për këtë objekt konform nenit 53, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe

Urdhrit të Ministrit nr.383, datë 25.05.2011, aneksi nr.2, “Miratimin e Formës dhe Përmbajtjes të Veprimtarive për Mbylljen e një Veprimtarie Minerare”.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.523 datë 05.10.1999, për mineral kromi, në objektin “Sheshi i Çukës”, Tërnovë, Bashkia Bulqizë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.523, datë 05.10.1999, për mineral kromi, në objektin “Sheshi i Çukës”, Tërnovë, Bashkia Bulqizë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTJA

